



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FIER
QENDRA EKONOMIKE E ARSIMIT FIER
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ Prot.

Fier, më .02.2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje gaz i lëngshëm për gatim”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Gaz i lëngshëm propan 09122110-4.

VLERA E FONDIT LIMIT: 1 087 832.5 (nje milion e tetedhete e shtate mije e teteqind e tridhete e dy pike pese) **lekë pa TVSH**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Qendra Ekonomike e Arsimit Fier ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 te ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ne te cilen eshte e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlogaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe ne nenin 30 te VKM nr.285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar.

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit sipas Shtojcës 8;

Argumentimi: Ky kriter u vendos bazuar ne nenin 76 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik“, dhe nenin 26 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar, ne te cilen eshte e percaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Kopje të deklaratave të xhiros vjetore, të realizuar nga Operatori Ekonomik ofertues gjatë 2 (dy) viteve të fundit (**2021, 2022**) lëshuar nga Administrata Tatimore, me vlerë jo me pak se **400 000 lekë pa TVSH** (e cila eshte nje vlerë jo më e madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet). Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur ne perputhje me piken 3 te nenit 77 te ligjit nr. 162/2020 "Per Prokurimin Publik", ne te cilin gjejme te percaktuar se: *3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.*; ne piken 1 dhe piken 2/c te nenit 43 te VKM-se nr. 285, date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik" i ndryshuar, ku percaktohet se: Pika 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare. Pika 2/c: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40% te vlerës se parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nen kufirin e ulët monetar;

Vendosja e ketij kriteri behet me qellim qe Autoriteti Kontraktor te sigurohet per aftesine ekonomike dhe financiare te OE ofertues, duke vertetuar nepermjet dokumenteve te kerkuara, se zoterojne kapacitet ekonomike dhe financiare per te permbushur kontraten sic eshte parashikuar nga AK. Kriteri i mesiperme eshte ne perpjestim dhe i lidhur ngushte me objektin e kontrates.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Pika 1 dhe pika 2/c e nenit 43 te VKM nr. 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik" i ndryshuar, parashikon marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohet në Procedurën e Hapur, perkatesisht; Pika 2/c: 2. *Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40% te vlerës se parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nen kufirin e ulët monetar;* Duke qene se kjo procedure prokurimi eshte bazuar ne vleren e fondit limit nen kufirin e ulët monetar, AK duke u bazuar ne eksperiencen e suksesshme te procedurave te zhvilluara me pare gjykon se është e pershtatshme vendosja e kriterit te marzheve maksimale të përcaktuara në Legjislacionin dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM nr.285, date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik" i ndryshuar ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit*

financiare; si dhe nenit 13 të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 "Për Tatimin Mbi të Ardhurat" i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për deklaratat individuale vjetore e të ardhurave; Njesia e prokurimit ka gjykuar te nevojshme percaktimin e dy viteve te fundit ne perputhje me vleren e fondit limit te parashikuar.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, kërkohen dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Ne kete rast vlere e kerkuar eshte jo me pak se **200 000 lekë pa TVSH** (e cila eshte nje vlerë jo më e madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet), që është realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.

Per kete pike Operatori Ekonomik duhet te paraqese nje nga dokumentat e meposhtem:

- a- Vërtetime të lëshuara nga një ent publik ku shënohen datat, shumat, zërat dhe sasi të mallrave të furnizuara ose fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat, zerat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
ose
- b- Në rastin e përvojes së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenit 40, pika 4 dhe nenit 55 pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo me pak se **200 000 leke pa TVSH** (e cila eshte nje vlerë jo më e madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet) që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", piken 4 te nenit 40 dhe piken 4/b te nenit 55 të VKM nr.285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët

ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën sa 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Vendosja e këtij kriteri behet me qëllim që Autoriteti Kontraktor të sigurohet për aftësinë teknike të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet përvojës së mëparshme, se zotërojnë kapacitetet dhe aftësinë teknike për të përmbushur kontratën siç është parashikuar nga AK.

2.3.2 Operatori ekonomik të paraqesë licencë të vlefshme për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë, lëshuar nga organet e pushtetit vendor *(në përputhje me nenin 11 gërma 'd' dhe nenin 20, pika 2 të ligjit nr.8450, datë 24.02.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre" i ndryshuar)*.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", në pikën 5 /a të nenit 40 të VKM nr.285 date 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, në të cilën është e përcaktuar se: *5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, si dhe bazuar në nenin 11 gërma 'd' dhe nenin 20, pika 2 të ligjit nr.8450, datë 24.02.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre" i ndryshuar.* Paraqitja e licences është kërkuar për të vërtetuar se operatori ekonomik ushtron aktivitet të rregullt në përputhje me legjislacionin në fuqi për fushën perkatese. Ky kriter është vendosur me qëllim që të shërbejë AK për të siguruar se operatori ekonomik plotëson kushtet dhe rregullat teknike sipas legjislacionit në fuqi.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë **një vetëdeklarim** ku të deklarojë se do të respektojë kushtet dhe rregullat teknike për përpunimin e bombolave dhe të deklarojë se ka në stafin e tij punonjës të çertifikuar për të bërë instalimin, testimin, si dhe çdo aspekt tjetër teknik që lidhet me objektin e prokurimit, për dorezimin dhe instalimin e bombolave të gazit në kuzhinat e institucioneve në varësi të QEA.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", në pikën 8 të nenit 40 të VKM nr.285 date 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, në të cilën është e përcaktuar se: *8. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për*

ekzekutimin me sukses të kontratës, si dhe bazuar ne ligjin nr.8450, datë 24.02.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre" i ndryshuar.

Paraqitja e ketij vetedeklarimi eshte kerkuar per te vertetuar se operatori ekonomik ushtron aktivitet te rregullt ne perputhje me legjislacionin ne fuqi dhe respekton kushtet dhe rregullat teknike. Ky kriter eshte vendosur me qellim qe ti sherbeje AK per te siguruar se operatori ekonomik i zoteron te gjitha kapacitetet teknike (bombola gazi te testuara per sigurine e tyre dhe punonjes te certifikuar per instalimin e tyre) per te permbushur me sukses kontraten.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike jane vendosur nga specialistja e fushes ne baze te urdherit Nr.09, date 15/01/2024 të Qendres Ekonomike te Arsimit dhe dokumentacionit bashkelidhur saj jane derguar me shkresen nr. 42/2 prot. date 09/02/2024 ne Q.E.A dhe protokolluar ne Bashkine Fier me nr. 1544 , date 13/02/2024, si dhe ne perputhje me nenin 4, pika 38/b, nenin 36 te ligjit nr.162/2020, "Per Prokurimin Publik", nenin 40, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

Specifikimet teknike gjenden bashkengjitur DST ne SPE.

Njësia e prokurimit: